
Ligji (1982:316) që ndalon gjymtimin gjenital të femrave

INFORMATION OM KÖNSSTYMPNING

Albanska



Sweden

Gjymtimi Gjenital

Sipas ligjit suedez (SFS 1982:316) gjymtimi gjenital në Suedi ndalohet.

Kushdo që shkel këtë ligj mund të dënohet deri në 10 vjet burg, edhe nëse gjymtimi gjenital ndodh jashtë Suedisë. Tentativat dhe përgatitjet për gjymtim gjenital gjithashtu janë të paligjshme, por edhe nxitja e dikujt tjetër për të kryer gjymtim gjenital është gjithashtu e paligjshme. Konsiderohet e paligjshme edhe mos denoncimi i këtij fenomeni, nëse e dini se do të kryhet gjymtim gjenital. Pavarësisht se kush është personi që kryen gjymtim gjenital, prindërit e vajzës janë përgjegjës për parandalimin e kryerjes së gjymtimit gjenital dhe mund të dënohen për këtë krim në Suedi.

Ligji (1982:316) që ndalon gjymtimin gjenital të femrave



LÄNSSTYRELSEN
ÖSTERGÖTLAND



Polisen

Pasojat

Gjymtimi gjenital i femrës, njohur ndryshe si “synetllëku i femrës”, është abuzim me qëllim ndryshimin ose dëmtimin e organeve të jashtme gjenitale të një vajze apo gruaje. Gjymtimi gjenital shkakton dëmtim në shumë drejtime, si dhe mund të shkaktojë këto probleme ose menjëherë ose më vonë gjatë jetës:

- Hemorragji të rëndë gjatë procedurës
- Infeksione
- Dhimbje në zonën gjenitale
- Vështirësi në urinim
- Vështirësi gjatë menstruacionit
- Dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale, si për femrën ashtu edhe për burrin
- Dëmtim që mund ta pengojë gruan të mbetet shtatzënë
- Ndërlikime të lindjes
- Probleme mendore
- Vdekje

Llojet e gjymtimit gjenital

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) përcakton katër lloje të gjymtimit gjenital:

Lloji 1: Hiqet klitorisi dhe/ose veshja e tij.

Lloji 2: Priten klitorisi, buzët e brendshme (labia e brendshme) dhe ndonjëherë buzët e jashtme (labia e jashtme).

Lloji 3: Hiqen klitorisi, buzët e brendshme (labia e brendshme) dhe buzët e jashtme (labia e jashtme) dhe qepen për të mbuluar çarjen vaginale.

Lloji 4: Të gjitha procedurat e tjera të dëmshme për organet gjenitale, siç është shpimi.

Ndonjëherë përmendet "Syneti" kur flitet për lloje të ndryshme të gjymtimit gjenital. Të gjitha format e gjymtimit gjenital, përfshirë edhe "synetet" janë të paligjshme!



Polisen



**LÄNSSTYRELSEN
ÖSTERGÖTLAND**

*Ligji (1982:316) që ndalon gjymtimin gjenital të femrave
Detta material är framtaget av Länsstyrelsen Östergötland.*